KËRKESË
Nr. 3966/7, datë 6.2.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme, shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit", Bashkia Devoll.

Subjekti kërkues është Bashkia Devoll.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim që konsiston në masën e vlerësimit, të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas tabelës bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 873 470.7 (tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit"
Bashkia Devoll

Nr	Emri Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	ZK	Nr. pasurisë	Sipërfaqja e truallit/ m^2	Çmimi i truallit lekë/m^2	Vlera e truallit/lekë	Sipërfaqja e ndërtesës(m^2)	Vlera e ndërtesës/lekë	Vlera e përgjithshme e shpronësimit	Shënime
1	Idris Isaku	1187	5/165	24	2145	51480			51.480	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Verore Isaku Maklend Isaku Denisa Isaku	1187	5/567ND				28	749060,7	749060,7	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Arjan Begolli	1187	5/580	34	2145	72930			72930	Konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma								**873470,70**	